

AKT THEMELIMI DHE STATUT I SHOQERISE
"Aure Vita" SHPK

Sot ne Tirane, me date 06.11.2025(dymije e njezete e pese), shtetasit e meposhtem:

1- *Z.Dejvi Jonuzi* i datëlindjes 02/08/2001, me atesi Ardian dhe amesi Andelina, lindur në Korce dhe banues në Libonik Maliq , madhor me zotësi të plotë për të vepruar, pajisur me numër personal ID K10802027A

me cilësinë e "Ortakeve Themelues", me vullnet të lirë, të plotë e të sinqertë, mbështetur: Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi, Në ligjin 9901 date 14.04.2008, "Për shoqëritë tregtare" i ndryshuar, ne ligjin "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" në atë Doganor, Fiskal e Tatimor, kane themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin: "**Aure Vita**" SHPK më poshtë e quajtur "Shoqëria"

KREU I

Neni 1

Krijimi

Shoqëria "**Aure Vita**" SHPK, është person juridik i së drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (me poshtë e quajtur "Shoqëria").

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKR, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj. Shoqëria "**Aure Vita**" SHPK, është një e tillë, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortakët që përballojnë humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia

Shoqëria e ka selinë në Tirane , Rruga. "Margarita Tutulani" Pallati Viridario 1, Kati 3, Apartamenti nr.27, Njesia administrative nr5 Tirane . Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, me vendim të Asamblese se Ortakëve dhe vendim të Administratorit.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria ka këto objekt veprimtarie:

Turizëm dentar, ofrimin e të gjitha shërbimeve dentare pacientëve të huaj, duke përfshirë edhe udhëtimin, akomodimin, guidën turistike në Tiranë, etj. Import- Eksport tregtim me shumicë dhe pakicë të gjithë llojet e materialeve dhe paisjeve në fushën e dentistrisë. Përfaqësimi i mallrave dhe shërbimeve të ndryshme si në Shqipëri dhe jashtë saj. Prodhimin, tregëtimin, importin, shit-blerjen e implantëve dentare dhe materialeve të tjera dentare. Konsulencë dhe shërbime në fushën turizmit dhe hotelierisë në fusha të ngjashme. Kompania ka të drejtë që të bëjë kërkime tregu afatshkurterë dhe afatgjatë brenda dhe jashtë vendit. Blerje pasuri të luajtshme apo të paluajtshme, mjeteve të transportit t'i marrë ose t'i lëshojë me qera, të marrë pjesë në tenderin e tyre, Tregtim të materialeve të ndryshme, me pakicë dhe shumicë, në format e parashikuara dhe të lejuara nga legjislacioni shqiptar. Shoqëria, mund të kryejë për përmbushjen e qëllimeve të saj çdo lloj veprimtarie tregtare të lejuar nga ligji, Mund të hyjë në tratativa dhe biznese me shoqëri të tjera që kanë të njëjtin objekt veprimtarie për të realizuar fitime në fushat e përmendura në këtë nen.. Përfitojë, transferojë, të marrë apo japë me qera, të blejë dhe shesë, si dhe të kontrakttojë, të drejten e markes, patentes, licences, dhe të drejtat e tjera që janë të ngjashme me këto. Shoqëria mund të ushtrojë punët që tregohen në objektin e veprimtarisë së saj, brenda dhe jashtë vendit, mund të marrë pjesë, të përfitojë apo të transferojë nga/te palet e tjera, mund të marrë pjesë në kapitalët e personave juridikë dhe fizikë, të vendit apo të huaj, të krijuar ose që krijohen me qëllim tregtar, industri, etj., në lidhje me këto fusha.

Shërbime të përgjithshme në fushën e turizmit dhe akomodimit për turistët. Menaxhimi i pritjes dhe lehtësirave hoteliere. Turizëm dentar, ofrimin e të gjitha shërbimeve dentare për pacientët e huaj. Organizimi, shoqërimi, akomodimi, transporti dhe udhëtime turne në destinacione të ndryshme turistike dhe arkeologjike. Shërbime marketing, telemarketing, marketing digjital dhe të ngjashme për turizëm shëndetsor, turizëm dentar, turizëm të mjekësisë dhe kirurgjisë estetike, turizëm wellness. Mbeshtetja e pacientëve të huaj për sigurimin e biletave të udhëtimit dhe akomodimit në hotele si dhe organizimi i udhëtimeve turistike në Shqipëri. Shërbime konsulencë në fushën e rezervimeve, prenotimeve, akomodimeve, etj. Zhvillimi, krijimi dhe tregtimi i paketave turistike për këtë qëllim. Shoqëria mund të veprojë si agjent/ndërmjetës për kryerjen e aktiviteteve të mësipërme duke kontraktuar palë të treta për kryerjen e një pjesë apo të të gjitha shërbimeve dentare, mjeksore, estetike, wellness. Shoqëria për përmbushjen e objektivave të aktivitetit të saj mund të blejë në formë direkte apo indirekte kuota të pjesëmarrjes në shoqëri të tjera shqiptare ose të huaja që kanë objekt aktiviteti të ngjashëm ose të lidhur me të, të hyjë në marrëdhënie kontraktore, bashkëpunimi ose ortakërie me persona të tretë, private ose publike, vendas ose të huaj. Shërbim ndërmjetësimi për gjetjen e pacientëve referuar klinikave të tjera këtu dhe jashtë vendi. Planifikim dhe realizim i fushatave të ndryshme publicitare dhe promovuese. Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të saj përfshirë edhe aktivitetin e ofrimit të shërbimeve, tregëtimin, importimin dhe eksportimin e mallrave.

Investime dhe ndertim biznesesh ne fushen e hoteleri turizimit, Sherbime hoteleri- turizem, Organizim eventesh, sportive, kulturore, argetuese apo ceremoniale, shitblerje pasurish te paluajtshme, ofrim i sherbimeve taxi, tregtim biletash avioni, tregtim me shumice dhe pakice e artikujve te ndryshem, agroturizem dhe transport mallrash e udhetaresh. Shperndarje e produkteve apo sherbimeve te ndryshme, shitje biletash turistike, edhe organizime turesh turistike brenda dhe jashte vendit. Organizmi transporti turistik ajror, transport detar, bileta turistike. Dhenie automjeteve me qera.

Hapje, menaxhim, ndertim, administrim pasurish te paluajtshme, godina civile ose industriale, marrje-dhenie me qera te objekteve civile ose industriale, hapje, administrim, menaxhim, bar-kafe-restorant Investim ne pjesemarrjen e kuotave, ofrim sherbimi ndermjetesimi, konsultimi ne te gjitha fushat e biznesit.

Shperndarje e produkteve apo sherbimeve te ndryshme, shitje biletash turistike, edhe organizime turesh turistike brenda dhe jashte vendit. Organizmi transporti turistik ajror, transport detar, bileta turistike.

Neni 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

KREU II KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njqind mije) Lekë dhe është i ndare ne 1(nje) kuote. Ortaku I vetem zoteron nje kuotë të shoqërisë "**Aure Vita**" SHPK ku kuota e secilit ortak mbart nje vlere te barabarte me kontributin e ortakut ne kapitalin themeltar, perkatesisht si me poshtë:

Ortaku Dejvi Jonuzi zotëron nje kuote me vlere 100.000Lekë qe perben 100 % te vlerës totale te kapitalit themeltar te shoqërisë,

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime. Ortaket përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë;

Neni 7

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit të një eksperti të autorizuar për këto kontribute në natyrë sipas kërkesës së administratorit. Zvogëlimi i kapitalit realizohet me vendim të Asamblese se Pergjithshme se Ortakeve në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Projekti i zvogëlimit të kapitalit u komunikohet ekspertëve kontabël të autorizuar, në rast se ka të tillë, të paktën 7 ditë përpara datës së mbledhjes së Asamblese se Pergjithshme se Ortakeve të thirrur për të marrë vendim rreth këtij projekti. Zvogëlimi i kapitalit themeltar në një vlerë më të vogël se ajo e përcaktuar në nenin 6 të këtij statuti, e bën të detyrueshme marrjen e një vendimi prej shoqërisë për zmadhimin e kapitalit themeltar të paktën deri në vlerën minimale. Në të kundërt shoqëria duhet të shndërrohet në një formë tjetër. Në rast moszbatimi të kërkesave të këtij paragrafi, çdo person i interesuar mund të kërkojë në rrugë gjyqësore prishjen e shoqërisë. Kjo prishje nuk mund të shpallet, në qoftë se rregullimi është bërë në ditën kur gjykata mblidhet për të marrë vendim.

Neni 8

Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me miratimin e Asamblese se Pergjithshme se Ortakeve. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve, nëpërmjet akteve ligjore.

KREU III ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9

Organi Vendimarrës

1. Asamblese se Pergjithshme se Ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe " ç " të kësaj pike;
 - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
2. Asamblese se Pergjithshme se Ortakeve merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "e" dhe "ë" të pikës 1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.
3. Të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaket. Të gjitha Vendimet e marra nga ortaket regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
 - a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
 - c) investime;
 - ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i tretit ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.
4. Ortaku mund të përfaqësohet edhe nga një tjetër person, nëpërmjet prokurës.
5. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

Neni 10

Ndryshimet e Statutit

__Ndryshimet e statutit vendosen nga Asamblese se Pergjithshme se Ortakeve. Çdo ndryshim

statuti duhet të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 11

Administrimi

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblese së Përgjithshme së Ortakeve. Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve vendosin për sistemin e administrimit, dhe në rastin e një organi administrativ me shumë administratorë, përcakton numrin e tyre dhe kompetencat. Administratori/rët, mund të jenë ose jo ortakë të shoqërisë. Administratori mund të shkarkohet në çdo kohë.

Administrator i shoqërisë është *Z.Dejvi Jonuzi* i datëlindjes 02/08/2001, me atesi Ardian dhe amesi Andelina, lindur në Korce dhe banues në Libonik Maliq , pajisur me numër personal ID K10802027A

Administratori i shoqërisë do të ushtrojë kompetencat e tij në këtë detyrë për një periudhë 5 (Pese) vjeçare, sipas ligjit.

Neni 12

Kompetencat

Shoqëria administrohet nga një Administrator i vetëm.

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryej të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- c) përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijoj një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- e) regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- f) raportoj përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- g) Administratori ka të drejtë të kryej të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm.
- h) Administratori përfaqëson shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publikë dhe/ose privatë vendas apo të huaj,

autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të të gjitha shkallëve.

i) Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

j) Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

k) Administratori ka gjithashtu të drejtë të nënshkruaj kontrata të ndryshme në emër e për llogari të Shoqërisë, përfshi këtu kontratat e qirasë, shitjes, blerjes, kredive a hipotekimit të pasurive të paluajtshme, të nënshkruaje aktet e themelimit të shoqërive të tjera ku Shoqëria është ortak, të nënshkruaj e hartoj çdo dokument e të kryejë në emër të Shoqërisë çdo veprim përballë të gjitha Bankave shqiptare apo të huaja në lidhje me çeljen apo mbylljen e llogarive rrjedhëse të Shoqërisë, nënshkrimi i kontratave të ndryshme bankare për financimin e Shoqërisë si dhe të kryej veprime tërheqje e derdhje shumash nga këto llogari pa limit.

m) Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke pasur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

n) Klauzolat e këtij statuti që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët

Neni 13

Përgjegjësitë

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pa miratuara nga ortakët që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale pasojat përkatëse. Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit. Ortakët kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Ortaku që nuk është administrator, ka të drejtë në çdo kohë të informohet personalisht për veprimtarinë e shoqërisë dhe të njihet me llogaritë dhe dokumentet e shoqërisë.

Neni 14

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përgjatë vitit i parë - financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 15

Bilanci i shoqërisë dhe dividendët

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakeve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori. Mbledhja e Ortakeve vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 16

Ekspertët

Eksperti, nëse zgjidhet nga kjo tille, ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakeve. Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakut për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 17

Bilanci

Bilanci Kontabël vjetor miratohet mbi bazën e vendimit me shkrim nga ortakët të cilët jo vetëm që dokumentojnë miratimin e tyre por vendosin në lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore sipas nevojave të zhvillimit të mëtejshëm të shoqërisë dhe garantimin e veprimtarisë së rregullt të saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit të veçante etj.

Neni 18

Dividendi

Të ardhurat neto (Dividendi) që mbeten pas veçimit të fondeve ligjore të mësipërme dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të tretëve i

mbesin dhe i kalojnë në pronësi ortakëve të shoqërisë në përpjesëtim të drejtë me vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Neni 19

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak, edhe para plotësimit të afatit për të cilin është krijuar siç mund të jete:

- a) Humbja e kapitalit ose pamundësia e vazhdimit të mëtejshëm të veprimtarisë së saj.
- b) Në një nga mënyrat e parashikuara nga ligji " Për Falimentimin e Shoqërive Tregtare"
- c) Kur plotësohet afati i caktuar për ushtrimin e veprimtarisë tregtare. Në këtë rast Asamblese se Pergjithshme se Ortakëve marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojne mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

Neni 20

Bashkimi dhe ndarja

Shoqëria, me anë të bashkimit, mund t'i kalojë trashëgiminë e saj një shoqërie ekzistuese ose një shoqërie të re që ajo themelon. Shoqëria gjithashtu me anë të ndarjes mund t'i kalojë trashëgiminë e saj disa shoqërive të tjera ekzistuese ose disa shoqërive të reja. Ortaket e shoqërisë, që bëjnë kalimin e trashëgimisë së saj në kuadrin e operacioneve të përmendura më lart përfitojne pjesë të kapitalit themeltar nga shoqëria ose shoqëritë përfituese dhe sipas rastit një kompensim me para, vlera e të cilit nuk mund të kalojë 10 për qind të vlerës nominale të pjesëve të kapitalit themeltar të dhëna. Operacionet e përmendura më lart mund të realizohen ndërmjet shoqërive të formave të ndryshme. Bashkimi ose ndarja sjell prishjen pa likuidim të shoqërisë që zhduket, dhe kalimin e plotë të trashëgimisë së saj te shoqëritë përfituese, në gjendjen në të cilën ndodhet kjo trashëgimi në datën e realizimit përfundimtar të operacionit. Bashkimi ose ndarja sjell njëkohësisht për ortakët e shoqërive që zhduken marrjen e cilësisë së ortakëve të shoqërive përfituese sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e bashkimit ose ndarjes.

Neni 21

Afati i emërimit të likuidatorit, publikohet sipas kushteve që parashikon ligji përkatës duke specifikuar dhe dokumentet që duhen depozituar në Aneksin e Regjistrimit Tregtar.

Neni 22

Likuidatori është i detyruar që të jetë i vëmendshëm dhe korrekt, si për realizimin e të drejtave për subjektet ndaj të cilëve shoqëria është kreditore dhe për ekzekutimin e detyrimeve, debive që shoqëria ka ndaj shtetit, shtetasve të veçante apo personave fizik apo juridik vendas apo të huaj.

Neni 23

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për shoqëritë

Tregtare", i ndryshuar me ane të ligjit Nr. 129/2014, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Piken c. 9901, datë: 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 24

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 25

Dispozita përfundimtare

Ky statut perben dokumentin e vetem te shoqerise qe parashikon themelimin dhe organizimin e veprimtarise se shoqerise. Ky Statut mund te ndryshohet, rishikohet dhe/ose shfuqizohet pjeserisht ose teresisht dhe te zevendesohet me nje statut te ri vetem me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve sipas shumices se cilesuar te percaktuar me siper.

Per sa nuk eshte parashikuar ne kete statut, ortaket do ti referohen legjislacionit tregtar Shqiptar ne fuqi si dhe praktikave tregtare ne vend.

Ky statut u redaktua ne 4 ekzemplare, me permbajtje dhe vlere te njejte juridike, ne gjuhen Shqip dhe u nenshkrua nga palet pa asnje rezerve.

ORTAKET THEMELUES

Z. Dejvi Jonuzi

A handwritten signature in blue ink, reading "Dejvi Jonuzi", followed by a stylized flourish or mark.